**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Një ankesë kundër: Autoritetin Kontraktues - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **214-22-12927-1-1-1** |
| **Nr i brendshëm** | **214-22-121-1-1-1** |

Sa i përket tenderit për: **“Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve**

**1. Identifikimi i ankuesit***

**Grupi i OE “TSR SH.P.K. & EHA Hoffmann International GmbH”**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Rr. Fehmi Lladrovci Fush Kosovë**

*(Adresa)*

*Fushë Kosovë* — ***12 000***

*(Vendi)* — *(Kodi postar)*

**+38344517428** — *N/A*

*(Numri Telefonit)* — *(Numri i Faks-it)*

**Marksim Malsiaj,Drejtor**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**info@tsr-ks.com**

*(Adresa elektronike)*

**16.03.2024**

(Data e parashtrimit të ankesës) — (Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

___

*(Emri i avokatit)*

___

*(Adresa e plotë)*

___ ___

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

___

*(Adresa elektronike)*

___ ___

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 09.12.2022 ndërsa hapja publike është bërë në datën 20.01.2023.

Fillimisht AK e ka anuluar tenderin por pas ankesave të parashtruara në OSHP lënda është kthyer ne rivlerësim. AK e ka rivlerësuar tenderin dhe ka dal me njoftim të ri mbi Vendimin e AK-së në datën 28.09.2023. Për shkak të vendimit të OSHP ky aktivitet sërish është kthyer në rivlerësim ndërsa me datë 01.03.2024 është publikuar njoftimi i fundit mbi vendimin.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohor i jemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim e tani edhe OSHP-së me ankesë

Kriteri i dhënies ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** [X] **Jo** [ ]

| |
|---|
| Hapja publike është bërë në datën 20.01.2023. Në procesverbalin e hapjes publike nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje apo shkelje ligjore |

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [X] **Jo** [ ]

**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së**

**AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së**

**AK ka shkelur nenin 10 të LPP-së**

**AK ka shkelur nenin 11 të LPP-së**

**AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së**

**AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së**

**AK ka shkelur nenin 29 të LPP-së**

**AK ka shkelur nenin 53 të LPP-së**

**AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së**

**AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së**

**AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së**

**AK ka shkelur nenin72 të LPP-së**

**7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

**Fillimisht ju sqarojmë se ky aktivitet i prokurimit është stërzgjatur me vendime kundërthënëse të autoritetit kontraktues, sidomos në raport me OE e rekomanduar për kontratë.**
**Në njoftimin mbi vendimin e fundit të publikuar me dt.01.03.2024 është rekomanduar për kontratë OE "GSG SHPK&KiG d.d, ndërsa ne jemi shpallur tenderues i pasuksesshëm.**

**Pretendimi 1**:
AK nuk ka respektuar nenin 1 të LPP, pasi që gjatë administrimit të procedurës së prokurimit për "Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve" nuk ka luajtur rol aspak aktiv që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike. Kjo ka ndodhur pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka respektuar kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit, kërkesat e modifikuara para hapjes publike përmes sqarimeve dhe nuk i ka cilësuar si duhet dhe në përputhje me LPP mangësitë në ofertat e tenderuesve. Si pasojë e këtyre veprimeve të AK-së, ka ardh edhe deri tek shkeljet ligjore ku AK-së shpërblen me kontratë një OE të papërgjegjshëm G.S.G&KIG. Krejt këto veprime e bëjnë përgjegjës AK-së, drejt shkeljes së nenit 1 të LPP-së lidhur me mos shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë të drejtë, efikase dhe transparente. Thjesht nuk është respektuar parimi kryesor i LPP-së që ka të bëjë me mënyrën e shfrytëzimit të fondeve publike në mënyrë transparente dhe publike.

**Pretendimi 2:**
AK nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, pasi që shihet qartë se ka favorizuar kompaninë e shpallur fituese dhe na ka diskriminuar neve si kompani e përgjegjshme (Jo për të parën Herë) edhe pse i kishim plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Kjo ka ndodhur si pasoj e veprimeve të AK-së, ku gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta të dosjes së tenderit, ndërsa edhe përkundër mangësive në dokumentacion dhe specifika teknike, e trajton si të përgjegjshme ofertën e Grupit të OE "GSG &KiG.". Kjo tregon haptazi se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së duke bërë trajtim jo të barabartë të tenderuesve. Pra autoriteti kontraktues ka përdor standarde të dyfishta duke interpretuar ndryshe kërkesat e dosjes së tenderit në raport me OE e rekomanduar për kontratë, prandaj ky është favorizim i hapur i OE të rekomanduar për kontratë dhe diskriminim i kompanisë tonë.

**Pretendimi 3.** AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së i cili THOTË Citojmë: **Neni 27 Dosja Tenderit** Përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkese të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese. Autoriteti kontraktues nuk Ju ka përmbajtur kërkesës se vet tek specifikacionet teknike . AK-së ka bërë shkelje të këtij neni duke e shpallur fitues OE "GSG -KiG.". i cili nuk i plotson kërkesat sipas specifikacionit Teknik të Perpiluar nga vet AK. Pra autoriteti kontraktues nuk i është përmbajtur kërkesave që vetë i ka përcaktuar në dosje të tenderit duke e favorizuar OE e rekomanduar për kontratë.

**Pretendimi 4.** AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së- Specifikimet teknike. AK duke mos i respektuar Specifikacionet teknike të vendosura vet në DT dhe të Modifikuara më vonë me pyetje përgjigje bën shkelje të këtij neni duke shpallur fitues një OE ("GSG -KiG."). i cili nuk plotëson specifikat teknike.

**Pretendimi 5.** AK ka shkelur nenin 29 të LPP-së **Variantet e specifikimeve teknike** – AK-së duke Pranuar Si të vlefshme variantet e OE ("GSG &KiG."), bënë shkelje të këtij neni pasi që ky nen e parasheh shumë mirë citojmë; pika 2 Autoriteti kontraktues duhet të tregoj në dosjen e tenderit nëse ata autorizojnë variante apo jo; variantet nuk do të autorizohen pa këtë indikacion. Në këtë tender nuk janë autorizuar variantet. AK Duke pranuar një OE si te përgjegjshëm me variante te Modelit jashtë Specifikacionit teknik të kërkuar vepron në kundërshtim me Nenin 29 te LPP-se, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga konkurrenca.

**Pretendimi 6.** AK ka shkelur nenin 53 të LPP-së Pasi që ky ligj thotë shumë qartë citoj; Pika 4.Autoriteti kontraktues menjëherë do të shqyrtojë çfarëdo kërkesë të tillë për të përcaktuar nëse operatorët ekonomik kanë apo nuk kanë nevojë për informatat sqaruese ose plotësuese të kërkuar në mënyrë që të përgatisin një tender të përgjegjshëm. Vet fakti qe thotë AK duhet ti sqaroj OE me informata shtesë qe çdo OE te jetë ne gjendje qe te përgatis sipas atyre informatave një tender te përgjegjshëm. Duke u nisur nga fakti qe AK pas kërkesës së OE për sqarime shtesë të Datës 5.01.2023 **Deshmia Nr 1**



Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Informacione, sqarime shtesë

Data: 05.01.2023

Numri i Prokurimit: 214-22-12927-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-121-1-1-1– Titulli: "Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve

| | Pyetja | Përgjigjja |
|---|---|---|
| 14 | LJu tek kerkesa e DT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 ju nen piken 2 kerkoni citojm , 2. Nje moster te targës me dimensione 520 x 110mm, sipas specifikimeve teknike Pytja e jon 1 eshte cila skice duhet te ju permbahemi | Sipas dizajnit grafik skica faqe 01 te ngarkuar ne platformën e prokurimit te datës,05.01.2023. |

Skica dhe parametrat e targave (Formati 52x11 cm)
Outline and parameters of the plates (Format 52x11 cm)
Skice i parametri za tablice (Format 52x11 cm)



Andaj Duke parë që ky OE ("GSG &KiG.".) nuk e sjell modelin e targave sipas specifikacionit teknik DHE pyetje Përgjigjeve, e që sipas dëshmisë nr 1 e bën këtë OE të pa përgjegjshëm sipas këtij neni dhe tregon për shkelje të bëra nga autoriteti kontraktues.

**Pretendimi 7:** AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka respektuar paragrafin 4 të këtij neni. Neni 59.4 i LPP-së e thotë qartë se:

*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*.
Arsyeja pse pretendojmë se AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së është se gjatë vlerësimit të tenderit që e ka shpallur fitues nuk i ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit Dhe sqarimet Shtes (Deshmija 1) Dhe Kerkesen e vet siç janë: **Deshmija Nr 2**




**Kështu Ka qen Kërkesa e AK Sipas specifikacionit teknik Dhe sqarimeve shtesë të datës 5.01.2024**

Lidhur me këtë tek specifikimi teknik ka qenë kërkesa: **Një Mostër Sipas Specifikimeve teknike.** Duke marrë Parasysh që disa OE kanë pas paqartësi se si duhet të sillet Mostra me çfarë dizajni dhe me çfarë shkronja dhe germa, Pyetjet për informata Shtesë i janë drejtuar AK-së, ndërsa AK më datën 5.01.2023 e ngarkon në Platformën e E-Prokurimit përgjigjen për OE se si duhet të sillet Mostra **( Dëshmia1- Deshmija 2).** Në këtë rast OE ("GSG &KiG.") i shpallur fitues, sjell modelin **01-444-AD** i cili Nuk Përputhet me Kërkesen e AK dhe njëkohësisht nuk përputhet me sqarimin për informata shtesë të ngarkuara më datën 05.01.2023. AK duke shpall të përgjegjshëm këtë OE ("GSG &KiG.") edhe pse nuk e plotëson këtë kërkesë Bazë, bënë shkelje të nenit 59 të LPP-së.

**Deshmia 3**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale | 9.1 & 9.2 | 2.Operatori ekonomik është i obliguar që për targat me të cilat ofertojnë duhen ta dorëzojnë një mostër të targës së rëndomtë e cila është në përdorim, me dimensione 520 x 110 mm së bashku me përshkrimin e specifikimeve teknike. Nëse nuk dorëzohet mostra dhe përshkrimi i specifikimeve teknike te mostrës oferta nuk do te merret ne shqyrtim dhe do te konsiderohet oferte e pa përgjegjshme. Mostra nuk është e obligueshme që ti kenë masat e veçanta të sigurisë, por duhet jenë ne harmoni me kualitetin e materialeve për prodhimin e targave sipas specifikave teknike te dhëna ne Aneksin 1 të Dosjes së tenderit. | 2. Një mostër të targës me dimensione 520 x 110mm, sipas specifikimeve teknike-MOSTRA e targave dorëzohen fizikisht para hapjes se ofertave, në një zarf të mbyllur. |

**Pretendimi 8:** AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka respektuar kërkesat e paragrafit 4 të këtij neni. Neni 59.4 i LPP-së e thotë qartë se Citojm :
Pika 4 *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*. Duke Marr Parasysh qe specifikacionet teknike kanë qenë të publikuar nga AK dhe duke marr parasysh qe AK publikon ne Platformen e E-Prokurimit me daten 05.01.2023 Sqarimet shtesë se si duhet te sjellet Modeli, dhe duke marr parasysh qe OE ("GSG -KiG.") i shpallur fitues nuk e sjell Modelin sipas sqarimeve te AK-së dhe informatave shtesë te AK bënë shkelje të nenit 59 të LPP-së.(Deshmia 1). Sipas skices së AK të ngarkuar ne E-Prokurim shihet shumë qartë se Modeli i cili duhet te sjellet duhet ta Ketë në anën e Majtë shenjat RKS te vendosura na folie në mënyrë vertikale **Dëshmia 1- Dëshmia -2 Dëshmia 3** .Këtu AK bën Përsëri shkelje të këtij neni, sepse OE i rekomanduar për kontratë sjell modelin pa këto karakteristika dhe këtë e Konfirmon edhe vet raportit i Forenzikës(Deshmija 2), por për çudi AK e anashkalon edhe këtë fakt dhe e shpall të përgjegjshëm një OE ("GSG -KiG.") i cili realisht dhe faktikisht është i pa Përgjegjshëm.

**Pretendimi Nr 9** Kërkesa tjetër te pika (9.1&9.2).3 e FDT-së ishte që për targen (Modelin ) të dorëzohet Test Raporti nga Laboratori apo instituti i autorizuar. Po që se shikohet me vëmendje, me vet faktin që tabela e tillë nuk posedon të dhënat sipas skices (Deshmija Nr 1) sipas kërkesës së AK-së, tregon hapur se edhe Test Raporti nuk është në rregull dhe nuk është punuar në përputhje me kërkesën e AK-së. Nisur nga ky fakt, bindëse dhe ligjore(Disponojm Deshmi bindese DESHMIJ NR 14) mendojmë se ky Grup i OE për mungesë të këtij raporti (Test Raporti për Targën RKS 01-999-AD) do duhet cilësuar si i papërgjegjshëm dhe jo te shperblehet me kontrat . Këtë edhe na Konfirmon Vet laboratori DEKRA (Dëshmia Nr. 14), ndërsa për këtë pretendim me tepër sqarohet tek pretendimi nr.12.
**Pretendimi Nr 10** Tek pika (9.1&9.2).5 e FDT-së AK kishte kërkuar që OE të ofrojnë **certifikatën ISO 7591** të cilën si kërkesë të FDT-së e kishte larguar përmes sqarimeve. Pavarësisht kësaj e njëjta kërkesë ka mbetur aktive të pika **10 e Aneksit 1. Shi piken 10 tek specifikimet teknike te detyrueshme.** Po ashtu analizoni edhe sqarime shtesë **sqarimi n**r. 7 **Dëshmia 4**

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs
**Informacione, sqarime shtesë**
Data: 05.01.2023

| Numri i Prokurimit: 214-22-12927-1-1-1; Numri i brendshëm: 214-22-121-1-1-1– Titulli: "Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve | | | |
|---|---|---|---|
| | Pyetja | | Përgjigjja |
| 8 | Specifikimet teknike te detyrueshme- Specifikimi detal për furnizim me targa të Republikës së Kosovës<br>Pika 10- Furnizuesi obligohet të bashkangjitë certifikata dhe dëshmitë që prodhuesi i targës i plotëson standardet e poshtëshënuara .(bashkangjitur kerkesat) | Këto kërkesa janë obligative per ofertuesin apo do të përmbushen nga furnizuesi pas nënshkrimit te kontratës perkatësisht gjatë furnizimit, sepse ne dosje thuhet se "Furnizuesi obligohet të bashkangjitë certifikata dhe dëshmitë që prodhuesi i targës i plotëson standardet e poshtëshënuara". | Kërkesat janë obligative për ofertuesit ne rastin e dorëzimit te ofertave. |

Kerkesa sipas specifikacjonit Teknik sa i perket Pikes 4.1 tek shiritat Me ngjyr te zez ka qen

4.1 Shiritat me ngjyrë të zezë për shkronja dhe numra, detyrimisht duhet të kenë shenjen RKS të përsëritur periodikisht në të gjithë gjatësinë dhe gjerësinë e tyre .

Orientimi i shenjës RKS do të bëhet në linjën, në këndin 45 shkallë me konturat e shiritit në distancë 4.0 mm dhe 5.5 mm nga njëra tjetra.

Ngjyra e shenjave duhet të jetë e zezë, por me nuancë të ndryshme nga ajo e shiritit.

E kjo Kerkes Plotsohet me rastin e kerkeses per sqarim shtes te OE te dates 05.01.2023 Pergjigja 7

**Deshmija 5**



| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7 | 1 | Specifikimet teknike te detyrueshme-Specifikimi detal për furnizim me targa të Republikës së Kosovës<br>Pika 4.1 Shiritat me ngjyrë të zezë për shkronja dhe numra, detyrimisht duhet të kenë shenjen RKS të përsëritur periodikisht në të gjithë gjatësinë dhe gjerësinë e tyre. | Ju lutem a mund të na bashkangjitni ndonjë vizatim detaj në lidhje me madhësin e shkronjave dhe fontin e tyre? | 999 |

Kjo Ka qenë Përgjigja e AK sa i Përket shiritave të zi, ku shumë qartë shihet se Shkronjat dhe Gerrmat duhet të kenë Shenjat me fronti RKS

Duke u nisur nga fakti se ky OE **nuk e posedon fare këtë Certifikatë 7591 Për Folien e Zezë Sipas Kërkesës së DT** dhe sqarimeve shtesë të datës 5.01.2023 ku shumë qartë në përgjigjen e AK thuhet **CITOJMË** "**Kërkesat janë Obligative për ofertuesin në rastin e dorëzimit të tenderit"(Deshmija 4)** dhe atë sipas pyetjes duhet të jetë sipas specifikimeve teknike te Republikës së Kosovës(Deshmija Nr 5) dhe fakti i lartcekur e bën OE e rekomanduar për kontratë të pa Përgjegjshëm, ndërsa AK duke e cilësuar këtë OE Si të përgjegjshëm bënë shkelje të nenit 59 të LPP-së dhe anashkalon kërkesat e dosjes së tenderit.
Sa i përket test raportit të cilin ky OE ("GSG &KiG.") e prezanton, test raporti i lëshuar nga Laboratori Dekra, e ku në seancën e fundit të OSHP i referohej ky OE. Duhet cekur dhe sqaruar se në këtë laborator nuk janë testuar fare folia e zezë sipas karakteristikave të dhëna në specifikacionin teknik dhe në sqarimet apo informata shtesë të publikuara nga AK më datën 05.01.2024. Këtë e dëshmon edhe vet Laboratori Dekra në përgjigjen drejtuar neve. **Dëshmia Nr 14** ku kjo shifet edhe ne foton e teslaboratorit Dekra te cilen ky OE ja ka bashkangjitur DT me rastin e dorzimit te tenderit **Deshmija 6**




Fig 1: Test samples "Kosovo" as an example in the condition as-supplied

Deshmija Qka ka testuar Ky OE ku shifet qart folie standarte dhe jo sips specifikacjonit teknik te kerkuar dhe pas shenja RKS

Se ky produkt nuk është testuar fare e verteton edhe Laboratori DEKRA **Deshmia NR 14** te cilit i referohet vet OE i shpallur fitues. Ky në përgjigjën e vet e sqaron shumë mirë se është testu folie standarde pa asnje shkrim apo inskript (Deshmija14). Kësaj do ti referohemi me shumë në Pretendimin12 mirëpo se është testu vetëm folie e zezë dhe atë pa shenjat RKS shifet edhe ne test raportin e dorëzuar nga ky OE dhe foton qe ja bashkangjit laboratori dekra si deshmi se çfarë është testu (**Dëshmia Nr 6).Andaj ky OE sa i perket kesaj kerkese te OE do te duhej te shpallej i papegjegjshem Pasiqa si Ploteson dy kerkesat ne ket pik:dhe at**

1. **Nuk e posedon Certifikaten ISO 7591 per ket produkt e cila shum mir sqarohet pytje Pergjegje Deshmija 4**
2. **Nuk e posedon Test raportin sipas kerkeses se AK e sqaruar edhe me Pytje pergjegj (Deshmija 4 dhe 5)**

Modeli që Dërgohet për testim Nga OE GSG&KIG sipas deshmisë së lëshuar nga Laboratorit Dekra, shihet shumë qartë se është shirit i zi standard, mirëpo në qoftë se AK do të dëshironte ta sqarojë këtë çështje dhe këtë pretendim, atëherë shumë lehtë do ta sqaronte një gjë të tillë, duke iu drejtuar laboratorit DEKRA që ta pyes se a është testu folia e kërkuar sipsa specifikacionit teknik? Sikurse veprojmë ne, dhe shumë lehtë do ta kishin marr përgjigjen siç e marrin ne (DESHMIA14)
Ky OE-ja sjell gjithashtu një test raport të lëshuar nga laboratori slloven **Zag**, me numër 47/23-461-3-EN (i pa akredituar; **kërkesa ishte që duhej të ishte i akredituar**). Ky raport i testimit, përveç se vjen nga një laborator i pa akredituar, është gjithashtu më i vjetër se 36 muaj, gjë e cila është qartë e cekur në pyetje përgjigje që nuk pranohen me më shumë se 36 muaj të vjetër. Kështu, duke pranuar këto mangësi si të mirëqena dhe duke anashkaluar vetë kërkesat e veta, AK bën shkelje ligjore në mënyrë të qartë, dhe ne vend qe ta eliminoj këtë OE, e shpërblen me Kontratë.

**Pretendimi Nr 11**. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së, pasi gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka respektuar paragrafin 4 të këtij neni. Neni 59.4 i LPP-së thotë qartë se "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."
Kërkesa e dosjes së tenderit kaq enë si në vijim "Kërkesa ishte që të testohej një fletë e bardhë reflektuese në emër të prodhuesit të tabelës në një laborator të akredituar, pra ka qenë shumë e qartë. OE ("GSG &KiG.") në lidhje me këtë kërkesë sjell një **test raport** i cili është lëshuar nga Laboratori Slloven Zag, me numër 47/23-461-2-EN, lëshuar më 19-01-2023, një ditë para hapjes së DT mirëpo ky laborator nuk është i akredituar për testim sipas standardit ISO 7591.
**Deshmia Nr.** 7

**10. Furnizuesi obligohet të bashkangjitë certifikata dhe dëshmitë që prodhuesi i targës i plotëson standardet e poshtëshënuara.**

| Materiali që kërkohet | Dokumenti që kërkohet | Kërkesa |
|---|---|---|
| Mostra sipas standardit ISO 7591- Fletë e bardhë retroreflektuese së bashku me vijat virtuale të sigurisë dhe shenjat drejtuese të sigurisë | Raport testues i adresuar në prodhuesin e tabelës së regjistrimit në pajtim me standardin ISO 7591i lëshuar nga laboratori i akredituar. | Rezultate pozitive në pajtim me standardin ISO 7591 |

Kerkesa Ka qen Shum e Kjart dhe at testim nga nje Laborator I Akredituar

Laboratori Slloven ZAG nuk është i akredituar për të testuar sipas standardit ISO 7591, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.
Ne kemi dëshmi të lëshuar nga vetë Akreditimi slloven, të cilës i referohet edhe vetë firma KIG kinse laboratory ZAG ku kryen testimet për poz e kerkuara te pikes 10 dhe at pozicionin 6 dhe 7 është i akredituar nga akreditimi Slloven, mirëpo në posedojmë dëshmi të lëshuar pikërisht nga akreditimi Sllovn (**Deshmija Ne 9)** që të **lartëpërmendurit deri sot nuk kanë akredituar asnjë laborator për testim sipas Standartit ISO 7591** po

labortori i lartëpermendur ZAG testimet sipas standardit ISO 7591 i bën në mënyrë vullnetare. Këtu shtrohet pyetja se përse AK nuk pyet Akreditimin Slloven siç bën pyetje per OE nga Shqipëria se laboratori AQSCERT a është i akredituar për testim sipas standardit ISO 7591. **Pra pse nuk pyet edhe për Laboratorin ZAG se a është i akredituar për testim sipas standardit ISO 7591**.Nga ky fakt shihen standardet e dyfishta të AK-së e që realisht favorizojnë OE e rekomanduar për kontratë. Duke pa këtë mangësi është dashur që këtë OE ta eliminoj nga konkurrenca, e jo ta shpall të Përgjegjshëm, andaj edhe në këtë rast AK ka bërë shkelje të Nenit 59.4 të LPP-së dhe nuk ka respektuar edhe neni 7, pasi që ka favorizuar OE e rekomanduar për kontratë ndërsa neve na ka diskriminuar në këtë rast.

**Pretendimi nr 12** AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka respektuar paragrafin 4 të këtij neni. Neni 59.4 i LPP-së e thotë qartë se Citojm :

Pika 4 Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Kerkesa e dosjes së tenderit Ka qen shumë e qartë **Deshmija Ne 8**



**10.** Furnizuesi obligohet të bashkangjitë certifikata dhe dëshmitë që prodhuesi i targës i plotëson standardet e poshtëshënuara.

| Materiali që kërkohet | Dokumenti që kërkohet | Kërkesa |
|---|---|---|
| Mostra sipas standardit ISO 7591- Fletë e gjelbër retroreflektuese. | Raport testues i adresuar në prodhuesin e tabelës së regjistrimit në pajtim me standardin ISO 7591i lëshuar nga laboratori I akredituar, | Rezultate pozitive në pajtim me standardin ISO 7591 |



Këtu, Autoriteti i Konkurrencës (AK) po kryen të njëjtin veprim, duke shkelur Nenin 59.4 të LPP-së dhe Ligjin e Konkurrencës duke deklaruar të përgjegjshëm një Operator Ekonomik (OE) i cili sjell një raport testimi nga një laborator i papërcaktuar si Laboratori ZAG nga Sllovenia. Për të plotësuar këtë kusht, ky OE sjell një RAPORT TESTI nga Laboratori ZAG me numër 47/23-461-2-EN lëshuar më 19 Janar 2023, një ditë para hapjes së tenderit (Vërehet që ata moren në mënyrë të shpejtë këtë dokument dhe në mënyrë taktike, përpiqen të shpëtojnë ç'të mundin). Megjithatë, raporti i testimi i lëshuar nga ky laborator nuk është i vlefshëm sepse ky Laborator nuk është i Akredituar për testim sipas standardit ISO 7591. Kërkesa ishte që **të testohet një fletë jeshile reflektuese në emër të prodhuesit të tabelës në një laborator të akredituar**, ndërsa Laboratori Slloven ZAG nuk është akredituar për të testuar sipas Standardit ISO 7591, kurse AK, Pa u siguruar për një gjë të tillë e konsideron të përgjegjshëm OE e rekomanduar për kontratë, edhe pse ne kemi dëshmi të lëshuara pikërisht nga Akreditimi Slloven që i përmenduri më sipër **nuk ka akredituar asnjë laborator për testim sipas Standardit ISO 7591** deri më sot, por laboratori i përmendur ZAG kryen teste sipas Standardit ISO 7591 në mënyrë vullnetare. Dëshmi; Prandaj, AK duhej ose të merrte informacione nga Akreditimi Slloven nëse ky Laborator është i akredituar siç vepron me laboratorë të tjerë dhe kështu ky OE duhej shpallur i papërgjegjshëm për mosplotësimin e kësaj kërkesë të DT.

Mirëpo, AK, duke besuar verbërisht dhe duke mos kërkuar sqarime fare pranon si të rregullta çdo dëshmi nga ky OE si të vërteta, duke bërë shkelje ligjore. **Bashkangjitet Dëshmia Letra e lëshuar nga Akreditimi Slloven.**

**Dëshmia 9** **leshuar nga Akreditimi Slloven me Perkthim**

**SLOVENSKA AKREDITACIJA**

Šmartinska cesta 152
SI-1000 Ljubljana
**T** +386 (0)1 547 32 50
**F** +386 (0)1 547 32 72
http://www.slo-akreditacija.si

i.A. Marksim Malsijaj
EHA
Hoffmann International GmbH
Deutchland

Datum: 24. 1. 2020

Dear Sir

With the reference to your question we have to inform you that we haven't granted any accreditations **according to the standard ISO 7591/1982**.

We have granted accreditation for retro reflection for floor markings and traffic signs according to the standards SIST EN 1436:2007 i EN 12899-1 to the following conformity assessment bodies:

- Zavod za gradbeništvo http://www.slo-akreditacija.si/acreditation/zavod-za-gradbenistvo-slovenije/
- Neks http://www.slo-akreditacija.si/acreditation/neks-druzba-za-inzeniring-meritve-in-prometno-signalizacijo-d-o-o/
- Igmat http://www.slo-akreditacija.si/acreditation/igmat-institut-za-gradbene-materiale-d-d/

Please check the scope of accreditation for above mentioned CAB's on our website (the links which we have provided above). The annex to the accreditation certificate clearly states the standards for which the conformity assessment bodies are accredited.

Kind regards,

dr. Boštjan Godec,
director

**AKREDITIMI SLLOVEN**

Šmartinska cesta 152
SI-1000 Lubjane
T +386 (0)1 547 32 50
F +386 (0)1 547 32 72
http://www.slo-akreditacija.si

i.A. Marksim Malsijaj
EHA
Hoffman International GmbH
Gjermani

Data: 24.1.2020

I nderuari Zotëri

Lidhur me pyetjen tuaj ju informojmë se nuk kemi dhënë asnjë akreditim **sipas standardit ISO 7591/1982.**

Ne iu kemi dhënë akreditimin për shenjat retro reflektive horizontale dhe shenjat e trafikut sipas standardeve SIST EN 1436:2007 i EN 12899-1 organeve për vlerësimin e pajtueshmërisë, si në vijim:

- Enti për ndërtimtari http://www.slo-akreditacija.si/acreditation/zavod-za-gradbenistvo-slovenije
- Neks http://www.slo-akreditacija.si/acreditation/neks-druzba-za-inzenirin-meritve-in-prometno-signalizacijo-d-o-o/
- Igmat http://www.slo-akreditacija.si/acreditation/igmat-institut-za-gradbene-materiale-d-d/

Ju lutemi kontrolloni fushëveprimin e akreditimit për organet për vlerësimin e pajtueshmërisë si më lart në ueb faqen tonë (në vegëzat e dhëna më lart). Shtojca e certifikatës së akreditimit qartë përcakton standardet për të cilat janë të akredituara organet për vlerësimin e pajtueshmërisë.

Sinqerisht,

Dr. Bošljan Godec
Drejtor (*nënshkrimi*)
(*vula e Slovenska Akreditacija*)

Andaj Duke Parë dëshmitë e pakontestueshme AK duke mos marrë fare mundin ti verifikoj faktet bën shkelje ligjore të Nenit 59 të LPP-së

